



**Republika e Kosovës - Republic of Kosova**  
**Komuna – Municipality**  
**Hani i Elezit**



01/Nr. 6416/2025  
Data: 14.08.2025

**PROCESVERBAL I KOMITETIT PER KOMUNITET**

Nga mbledhja e gjashte-VI- për vitin 2025 i Komitetit për Komunitete, mbajtur me datë: 30.07.2025 me fillim pune në ora 14:00 në sallën e takimeve.

**RENDI I PUNËS**

- 1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
- 2 .Takim me Nënkryetarin e Komunes
- 3.Takim me zyrtarin e zyres së Prokurimit
- 4.Takim me Drejtorinë e Urbanizmit , Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit
- 5.Eventuale

**U MIRATUA RENDI I PUNËS**

- 1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin; nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

**U MIRATUA PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR**

## **2 .Takim me Nënkryetarin e Komunes**

**Kryesuesi** thekson : lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin

**Sevdi Dernjani** thekson: Po filloj me disa projekte siq janë asfaltimi i rrugës Gorancë Krivenik faza e parë ndersa faza e dytë është në perfundim e siper ka perfundu procedura e prokurimit edhe me u bë lidhja e kontrates nese nuk ankohet dikush në oshp , janë berë edhe zotimet për parkingun tek xhamia në Paldenicë është në procedur e siper , shtrimi me kubeza etj

**Zaim Bela** thekson: Rruga e Fshatit Gorance a do të shtrohet me asfalt , dhe rruga Gorance Krivenik a do të shtrohet deri në Krivenik, edhe rruga tek Currat kur perfundon

**Sevdi Dernjani** thekson: Rruga Goranc Krivenik është faza e parë deri tek pishat ndersa faza e dyte deri në Krivenik .

**Sulejman Vila** thekson: Në postim shkruan që deri në Krivenik por asfaltimi është deri tek Pishat kur perfundon deri në Krivenik

**Sevdi Dernjani** : Faza e parë ka perfunduar 1.8 km deri tek pishat ndersa faza e dytë prej pishave deri në Krivenik faza e dytë është ne perfundim të procedurave të prokurimit deri në lidhjen e kontrates me fituesin nese nuk ankohet dikush për me anulu e me vazhdu me procedur te re , e rendesishme është qe mjetet janë siguru rruga do të shtrohet

**Zaim Bela** thekson: Rruga Gorance qe është duke u punuar kur perfundon

**Sevdi Dernjani** thekson: Ajo rrugë është duke u punuar deri në fundvit ajo është procedur e nivelit qendror. Ndersa rruga tek currat është shtru vitin e kalum shtresa e parë është në projekt edhe shtresa e dyt është nxjerr procedura e prokurimit ka dal ne tender janë ofru ofertat por kur janë hap ofertat nuk kanë qen kredibil dhe procedura e prokurimit e ka vlersu të pavlevshem, del prap ne procedur të prokurimit për me u shtru faza e dytë

**Ajnure Thaci** thekson: Tek rruga Goranc Krivenik e ka ujësjells dhe kanalizim

**Sevdi Dernjani** thekson: Për momentin është vetem asfaltimi ,

**Sulejman Vila** thekson: A ka me pas parking tek pishat

**Sevdi Dernjani** thekson : Po

**Hanumshahe Dibrani** thekson: Shqetesimi më I madh tek ne eshte uji ku është problemi 1 ore në dite ,

**Sevdi Dernjani** thekson: Ne fabriken e ujit qe ka fillu prej 2010 me u iplementu ne 2019 ka nis faza e dytë, si komune nuk menaxhojme me ujë I plotesojmë kerkesat që na vijne prej bifurkacionit , Bifurkacioni menaxhon me uje .

### **3.Takim me zyrtarin e zyres së Prokurimit**

**Kryesuesi** thekson : Vazhdojmë në pikën tjetër me radhe pasi që nuk është prezent

### **4.Takim me Drejtorinë e Urbanizmit , Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit**


**Kryesuesi** thekson : Vazhdojmë në pikën tjetër me radhe pasi që nuk është prezent

### **5.Eventuale**

Nuk pati diskutime

**Mbledhja perfundoj në 14:45**

**Procesmbajtësja**  
**Sara Berisha**



**Kryesuesi i Komitetit**  
**Resul Suma**

